

<b>Emertimi dhe Forma ligjore:</b>	<b>“NDERTIM MONTIMI E RE” sh.p.k</b>
<b>NIPT –i:</b>	<b>J73312211D</b>
<b>Adresa e Selise:</b>	<b>Elbasan</b>
<b>Data e krijimit:</b>	<b>22/08/1994</b>
<b>Nr. I Regjistrimit Tregtar</b>	<b>6025</b>
<b>Veprimtaria Kryesore:</b>	<b>Ndertim</b>

## **PASQYRAT FINANCIARE**

(Ne zbatim te Standartit Kombetar te Kontabilitetit Nr 2  
dhe Ligjit Nr. 25/2018, date 10.05.2018 “Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”)

### **VITI 2019**

Pasqyrat Financiare jane individuale  
Pasqyrat Financiare jane te shprehura ne Lek  
Pasqyrat Financiare nuk jane te rumbullakosura  
Periudha Kontabel e Pasqyrave Financiare nga 01.01.2019-31.12.2019  
Data e mbylljes se Pasqyrave Financiare 03.05.2020

Pasqyra e Pozicionit Financiar	Periudha Raportuese	Periudha Para ardhese
<b>AKTIVET</b>		
<b>Aktive afatshkurtra</b>		
Mjete monetare	64,259,167	40,946,795
Investime		
<i>Ne tituj pronesie te njesive ekonomike brenda grupit *</i>	0	0
<b>Te drejta te arketueshme</b>		
<i>Nga aktiviteti i shfrytezimit</i>	58,919,615	46,285,694
<i>Te tjera</i>	4,183,990	4,545,971
<i>Kapital i nenshkruar i papaguar</i>	0	0
<b>Inventaret</b>		
<i>Lende e pare dhe materiale te konsumueshme</i>	0	0
<i>Produkte te gatshme</i>	0	0
<i>Mallra</i>	0	0
<i>AAGJM te mbajtura per shitje</i>	0	0
<b>Shpenzime te shtyra</b>	0	0
<i>Objekt Banimi nr 2</i>	66,550,808	97,574,870
<i>Objekt Banimi nr 3</i>	146,733,297	146,733,297
<i>Shpenzime per tu shperndare</i>	8,014,014	6,620,687
<b>Te arketueshme nga te ardhura te konstatuara</b>	0	0
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>	<b>348,660,891</b>	<b>342,707,314</b>
<b>Aktive afatgjate</b>		
<b>Aktive financiare</b>		
<i>Tituj pronesie te njesive ekonomike brenda grupit *</i>	0	0
<b>Aktive materiale</b>		
<i>Toka dhe ndertesa</i>	0	334,450
<i>Impiante dhe makineri</i>	0	0
<i>Te tjera instalime dhe pajisje</i>	1,219,508	1,400,425
<i>Parapagime per aktive materiale dhe ne proces</i>	0	0
<b>Aktivitet biologjike</b>	0	0
<b>Aktive jo materiale</b>		
<i>Emri i mire</i>	0	0
<b>Aktivitet tatimore te shtyra</b>	0	0
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>	<b>1,219,508</b>	<b>1,734,875</b>
<b>TOTALI I AKTIVEVE</b>	<b>349,880,399</b>	<b>344,442,189</b>

Administratori

Beqir Shehu



Pasqyra e Pozicionit Financiar DETYRIMET DHE KAPITALI	Periudha Raportuese	Periudha Para ardhese
<b>Detyrime afatshkurtra</b>		
<i>Titujt e huamarrjes</i>	0	0
<i>Aktetime ne avance per porosi</i>	142,949,561	144,235,648
<i>Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit</i>	62,342,839	71,935,990
<i>Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore/shendetesore</i>	220,618	938,247
<i>Te pagueshme per detyrime tatimore</i>	11,777	12,723
<i>Te tjera te pagueshme</i>	0	0
Te pagueshme per shpenzime te konstatuara	0	0
Te ardhura te shtyra	0	0
Provizione	0	0
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>	<b>205,524,795</b>	<b>217,122,608</b>
<b>Detyrime afatgjata</b>		
<i>Titujt e huamarrjes</i>	0	0
<i>Te tjera te pagueshme</i>	0	0
Te pagueshme per shpenzime te konstatuara	0	0
Te ardhura te shtyra	0	0
Provizione		
<i>Provizione te tjera</i>	0	0
Detyrime tatimore te shtyra	0	0
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Detyrime totale</b>	<b>205,524,795</b>	<b>217,122,608</b>
<b>Kapitali dhe Rezervat</b>		
Kapitali i nenshkruar	35,150,000	35,150,000
Primi i lidhur me kapitalin	0	0
Rezerva rivleresimi	0	0
Rezerva te tjera		
<i>Rezerva ligjore</i>	200,000	200,000
<i>Rezerva te tjera</i>	91,969,581	89,468,324
Fitimi/(humbja) e pashperndare		1,264
Fitimi/(humbja) e periudhes	17,036,023	2,499,993
<b>Totali i kapitalit qe i takon pronareve njesise ekonomike</b>	<b>144,355,604</b>	<b>127,319,581</b>
Interesa jo-kontrollues		
<b>Totali i kapitalit</b>	<b>144,355,604</b>	<b>127,319,581</b>
<b>TOTALI I DE TYRIMEVE DHE KAPITALIT</b>	<b>349,880,399</b>	<b>344,442,189</b>

Administratori

Beqir Shehu



	Periudha Raportuese	Periudha Para ardhese
<b>Pasqyra e Performances (sipas natyres)</b>		
<b>Te ardhurat nga aktiviteti i shfrytezimit</b>		
<i>Te ardhurat nga aktiviteti kryesor</i>	51,589,463	5,903,680
<i>Te ardhurat nga aktiviteti dytesor 1</i>	977,940	0
<i>Te ardhurat nga aktiviteti dytesor 2</i>	5,037,984	6,229,910
<i>Te tjera te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit</i>	0	0
<b>Te ardhura nga ndryshimi ne inventarin e mallrave dhe prodhimet ne proces</b>	0	0
<b>Te ardhura nga puna e kryer nga njesia ekonomike per qellimet e veta dhe e kapitalizuar</b>	0	0
<b>Te ardhura te tjera te shfrytezimit</b>	0	0
<b>Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme</b>		
<i>Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme</i>	-864,522	-1,176,622
<i>Te tjera shpenzime</i>	-29,565	0
<b>Shpenzime te personelit</b>		
<i>Paga dhe shperblime</i>	-2,660,865	-2,608,716
<i>Shpenzime te sigurimeve shoqerore/shendetsore</i>	-444,371	-435,656
<i>Shpenzimet per pensionet</i>	0	0
<b>Zhvleresimi i aktiveve afatgjata materiale</b>	0	0
<b>Shpenzime konsumi dhe amortizimi</b>	-308,639	-378,179
<b>Shpenzime te tjera shfrytezimi</b>	-32,981,882	-5,410,528
<b>Te ardhura te tjera</b>		
<i>Te ardhura nga njesite ekonomike brenda grupit*</i>	0	0
<b>Zhvleresim i aktiveve financiare dhe investimeve financiare te mbajtura si aktive afatshkurtra</b>	0	0
<b>Shpenzime financiare</b>		
<i>Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme</i>	-63,752	899,230
<i>Shpenzime te tjera financiare</i>	-177,999	-69,658
<b>Pjesa e fitimit/(humbjes) financiare nga pjesmarrjet</b>	0	0
<b>Te tjera (pershkruaj)</b>	0	0
<b>Fitimi/(humbja) para tatimit</b>	<u>20,073,792</u>	<u>2,953,461</u>
<b>Tatimi mbi fitimin</b>		
<i>Tatimi mbi fitimin e periudhes</i>	-3,037,769	-453,468
<b>Fitimi/(Humbja) e periudhes/vitit (A)</b>	<u>17,036,023</u>	<u>2,499,993</u>
<b>Te ardhura te tjera gjithepershiresë per periudhen/vitin:</b>		
<i>Diferenca (+/-) nga perkthimi i monedhes ne veprimtari te huaja</i>	0	0
<b>Totali i te ardhurave te tjera gjithepershiresë per periudhen/vitin (B)</b>	<u>0</u>	<u>0</u>
<b>Totali i te ardhurave gjithepershiresë per periudhen/vitin (A+B)</b>	<u><u>17,036,023</u></u>	<u><u>2,499,993</u></u>

Administratori

Beqir Shehu





Pasqyra e fluksit te mjeteve monetare (metoda indirekte)	Periodha Raportuese	Periodha Para ardhese
<b>Fluksi mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit:</b>		
Fitimi/(Humbja) e periudhes	20,073,792	2,953,461
Rregullime per te ardhura dhe shpenzime jo-monetare:		
<i>Shpenzime konsumi dhe amortizimi</i>	308,639	378,179
<i>Shpenzime te shtyra</i>	29,630,735	0
<i>Shpenzime te tjera jo monetare</i>	317,728	0
 Fluksi i mjeteve monetare i perfshire ne aktivite investuese		
<i>Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale</i>	0	2,479,408
 Ndryshim ne aktivet dhe detyrimet e shfrytezimit		
Rënie/(ritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	-12,271,940	5,992,837
Rënie/(ritje) në inventarë	0	0
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	-14,111,044	-2,770,518
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	0	0
<b>Mjete monetare neto nga/ perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit</b>	<b>23,947,910</b>	<b>9,033,367</b>
Tatim fitimi i paguar gjate periudhes	-524,538	-1,450,866
 <b>Fluksi i mjeteve monetare nga/ perdorur ne aktivitetin e investimit</b>		
<i>Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale</i>	-111,000	0
<i>Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale</i>	0	0
<i>Dividentë të arkëtuara</i>	0	0
<b>Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e investimit</b>	<b>-111,000</b>	<b>0</b>
 <b>Fluksi i mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin e financimit</b>		
<i>Dividendë të paguar</i>	0	0
<b>Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e financimit</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
 <b>Rritje/(renie) neto ne mjetet monetare dhe ekuivalente me to</b>	<b>23,312,372</b>	<b>7,582,501</b>
Mjete monetare dhe ekuivalente me to ne fillim	40,946,795	33,364,294
Efekti i luhatjeve te kurseve te kembimit te mjeteve monetare		
<b>Mjete monetare dhe ekuivalente me to ne fund</b>	<b>64,259,167</b>	<b>40,946,795</b>

Administratori

Beqir Shehu



	Kapitali i nenshkruar	Rezerva te tjera (ligjore)	Rezerva te tjera	Fitim/(humbja) e periudhes	Totali
<b>Pasqyra e levizjeve ne kapitalin neto</b>					
<b>Pozicioni financiar ne fillim</b>	<b>35,150,000</b>	<b>200,000</b>	<b>71,847,288</b>	<b>17,622,300</b>	<b>124,819,588</b>
Efekti i ndryshimeve ne politikat kontabile					0
<b>Pozicioni financiar i rideklaruar ne fillim</b>	<b>35,150,000</b>	<b>200,000</b>	<b>71,847,288</b>	<b>17,622,300</b>	<b>124,819,588</b>
<b>Te ardhurat totale gjithëpërfshirëse te periudhes:</b>					0
Fitim/(humbja) e periudhes				2,499,993	2,499,993
Te ardhura te tjera gjithëpërfshirëse					0
<b>Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse per periudhen</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>2,499,993</b>	<b>2,499,993</b>
<b>Transaksione per pronaret e njësisë ekonomike te njohura direkt ne kapital:</b>					0
Emetim i kapitalit të nënshkruar					0
Dividende te shperndare					0
Percaktime te tjera per rezultatin e periudhes <i>(pershkruaj)</i>			17,622,300	-17,622,300	0
<b>Totali i transaksioneve per pronaret e njësisë ekonomike</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>17,622,300</b>	<b>-17,622,300</b>	<b>0</b>
<b>Pozicioni financiar ne fund (viti paraardhes)</b>	<b>35,150,000</b>	<b>200,000</b>	<b>89,469,588</b>	<b>2,499,993</b>	<b>127,319,581</b>
					0
<b>Te ardhurat totale gjithëpërfshirëse te periudhes:</b>				0	0
Fitim/(humbja) e periudhes				17,036,023	17,036,023
Te ardhura te tjera gjithëpërfshirëse					0
<b>Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse per periudhen</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>17,036,023</b>	<b>17,036,023</b>
<b>Transaksione per pronaret e njësisë ekonomike te njohura direkt ne kapital:</b>					0
Emetim i kapitalit të nënshkruar					0
Dividende te shperndare					0
Percaktime te tjera per rezultatin e periudhes <i>(pershkruaj)</i>			2,499,993	-2,499,993	0
<b>Totali i transaksioneve per pronaret e njësisë ekonomike</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>2,499,993</b>	<b>-2,499,993</b>	<b>0</b>
<b>Pozicioni financiar ne fund (viti aktual)</b>	<b>35,150,000</b>	<b>200,000</b>	<b>91,969,581</b>	<b>17,036,023</b>	<b>144,355,604</b>

Administratori

Beqir Shehu





**SHENIMET SHPJEGUESE****1. Informacion i përgjithshëm**

Shoqëria “NDERTIM MONTIMI E RE” sh.p.k është regjistruar pranë Zyres së Rregjistrimit Tregtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me Vendimin Nr. 6025 datë 29/08/1994. Shoqëria ushtron aktivitet në fushën e ndertimeve civile dhe ka kapital të regjistruar prej 35,150,000 leke, i cili zotërohet nga ortakët i vetëm Z. Beqir Shehu. Shoqëria administrohet nga ortakët i vetëm i saj, Z. Beqir Shehu. Shoqëria me 31 dhjetor 2019 ka patur 5 të punësuar (31 Dhjetor 2018: 6 të punësuar)

Organizimi dhe funksionimi i saj rregullohet sipas ligjit Nr. 9901 datë 14/04/2008 “*Per Tregtarët dhe shoqëritë tregtare*” statutit të saj dhe legjislacionit shqiptar në fuqi.

**2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare****2.1 Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin Nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Në bazë të urdhrit nr.64 datë 22.7.2014 “Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”, Ministria e Financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

**2.2 Bazat e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

**2.3 Biznesi në vijimësi**

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

**2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

**2.5 Vlerësime dhe gjykime**

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumë e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

**2.5.1 Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme**

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve.



Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

### 2.5.2 Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

### 2.6 Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar.

## 3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

### 3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2019	2018
Euro/LEK	121.77	123.42
USD/ LEK	108.64	107.82

### 3.2 Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme. Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e



mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë. Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

- Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

- Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet.

Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

- Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

- Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dheshpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

- Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

- Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

- Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.



- Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi. Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

### 3.3 Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

### 3.4 Aktive afatgjata material

#### i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetëndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në “Ndërtim në proces” dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktiviteti afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

#### ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.



iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2019 dhe 2018 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mobilje për zyren	Vlera e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25 %
Të tjera	Vlera e mbetur	20%

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5 Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6 Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7 Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3.8 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.



### 3.9 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital. Tatimi aktual është tatimi i pritur për t’u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t’u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 është 15% (2018: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet. Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

### 3.10 Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

### 3.11 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

### 3.12 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

### 3.13 Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë q një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.



**Bilanci kontabel, aktivet**

**4. Aktive monetare**

Gjendja e aktiveve monetare ne date 31.12.2019 eshte ne shumen 64,259,167 leke, si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2019	Viti 2018
1	Aktive monetare	64,259,167	40,946,795
	<b>Totali</b>	<b><u>64,259,167</u></b>	<b><u>40,946,795</u></b>

Difrencat e krijuara nga kurset e kembimit jane marre ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

**5. Te drejta te arketueshme**

Ne kete post paraqiten kerkesa ndaj te treteve te detajuara sipas tabelës se meposhtme, ne shumen 63,103,605 leke, me 31.12.2019.

Nr	Te drejta te arketueshme	Viti 2019	Viti 2018
1	Klient per shitje e sherbime	58,919,615	46,285,694
2	Tatim fitimi	208,656	2,721,887
3	Huadhenie	3,975,334	1,824,084
	<b>Totali</b>	<b><u>63,103,605</u></b>	<b><u>50,831,665</u></b>

**6. Shpenzime te shtyra**

Shpenzimet e shtyra paraqiten ne shumen 221,298,119 leke me 31.12.2019. Shoqeria ka dy objekte ne ndertim per vitin ushtrimor 2019. Te detajuara sipas tabelës se meposhtme:

Nr	Emertimi	Viti 2019	Viti 2018
1	Objekt banimi nr 2	66,550,808	97,574,870
2	Objekt banimi nr 3	146,733,297	146,733,297
3	Shpenzime te shtyra	8,014,014	6,620,687
	<b>Totali</b>	<b><u>221,298,119</u></b>	<b><u>250,928,854</u></b>

**6.3 Shpenzime te shtyra**

Shpenzimet e shtyra te paraqitura ne shumen 8,014,014 leke, i perkasin objekteve si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2019	Viti 2018
1	Pagesa per lejen e ndertimit objekti nr.4	3,635,249	2,241,922
2	Pagesa per lejen e ndertimit objekti nr.3	4,378,765	4,378,765
	<b>Totali</b>	<b><u>8,014,014</u></b>	<b><u>6,620,687</u></b>

**Aktive afatgjata**

**7. Aktivet materiale**

Gjendja e aktiveve eshte paraqitur me vleren kontabel te mbetur, me 31.12.2019 eshte 1,219,508 leke.

Nr	Aktive afatgjata materiale	Viti 2019	Viti 2018
1	Ndertesa	-	334,450
2	Të tjera pajisje dhe informatike	1,219,508	1,400,425
	<b>Totali</b>	<b><u>1,219,508</u></b>	<b><u>1,734,875</u></b>

Si politike kontabel per kontabilizimin dhe shpjegimin e AAM-ve, shoqeria ka zgjedhur modelin e koston (SKK-5). Vleresimi fillestar ne momentin e hyrjes eshte bere me kosto dhe ne daten e mbylljes se bilancit paraqiten me koston e tyre minus zhvleresimin e akumuluar dhe ndonje humbje nga renia e vleres. Drejtimi nuk ka llogaritur renie te vleres per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018.

**Bilanci kontabel, pasivet**

**8. Detyrimet Afatshkurtra**

Paraqiten detyrime afatshkurtra te shoqerise me 31.12.2019, ne shumen 205,524,795 leke si me poshte:

Nr	Detyrimet afatshkurtra	Viti 2019	Viti 2018
1	Arkëtime në avancë për porosi	142,949,561	144,235,648
2	Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	62,342,839	71,935,991
3	Të pagueshme ndaj punonjësve e sigurimeve	220,618	938,247
4	Të pagueshme për detyrimet tatimore	11,777	12,723
	<b>Totali I detyrimeve</b>	<b><u>205,524,795</u></b>	<b><u>217,122,608</u></b>

**8.1 Arkëtime në avancë për porosi**

Ne kete post paraqitet shuma e parapagimeve nga klientet per shitjen e objekteve te banimit deri me 31.12.2019 ne vleren 142,949,561 leke.

**8.2 Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit**

Ne kete post paraqitet gjendja e furnitoreve e palikujduar me 31.12.2019 eshte 62,342,839 leke. Vlerat e tyre ne monedha te huaja jane konvertuar me kursin e dates 31.12.2019 dhe diferencat jane kontabilizuar ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve sipas SKK-ve.

**8.3 Te pagueshme ndaj punonjësve e sigurimeve**

Paraqiten detyrime per paga te palikujduara e detyrimeve per sigurimet deri me 31.12.2019 gjithsej ne shumen 220,618 leke, nga te cilat sigurime te muajit dhjetor ne shumen 54,250 leke

**8.4 Te pagueshme per detyrimet tatimore**

Detyrimet tatimore paraqiten ne shumen 11,777 leke, te detajuara si me poshte:

Nr	Detyrimet tatimore	Viti 2019	Viti 2018
1	Tatimi mbi te ardhurat personale	6,297	6,297
2	Tatim mbi vleren e shtuar	5,480	872
3	Tatim ne burim	-	5,554
	<b>Totali I detyrimeve</b>	<b><u>11,777</u></b>	<b><u>12,723</u></b>

**9. Kapitali**

Grupi kapitaleve te veta jane te paraqitura si me poshte:

Nr	Emertimi	Kapitali I nenshkruar	Rezerva ligjore	Rezerva te tjera	Fitim I pashperndare	Fitimi I vitit	Totali
1	Gjendja me 31.12.2018	35,150,000	200,000	89,468,324	1,264	2,499,993	127,319,581
2	Shtesat per 2019	-	-	2,501,257	-	17,036,023	19,537,280
3	Paksimet per 2019	-	-	-	(1,264)	(2,499,993)	(2,501,257)
	<b>Gjendja me 31.12.2019</b>	<b><u>35,150,000</u></b>	<b><u>200,000</u></b>	<b><u>91,969,581</u></b>	<b><u>-</u></b>	<b><u>17,036,023</u></b>	<b><u>144,355,604</u></b>

Grupi i kapitaleve te veta eshte rritur me fitimin e vitit 2019 ne shumen 17,036,023 leke. Kapitali i regjistruar i shoqerise eshte 35,150,000 leke. Totali i grupit te kapitaleve te veta me 31.12.2019 eshte 144,355,604 leke.



**Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve**

**10. Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit**

Ne kete post jane rregjistruar te ardhurat e realizuara nga shoqeria per vitin 2019 ne shumen 57,605,387 leke, nga shitja e objekteve te banimit.

Nr	Emertimi	Viti 2019	Viti 2018
1	Te ardhura nga shitja e objektit	51,589,463	5,903,680
2	Shitje e punimeve dhe e sherbimeve	977,940	1,191,926
3	Te ardhura nga qeraja	5,037,984	5,037,984
<b>Totali i te ardhurave</b>		<b><u>57,605,387</u></b>	<b><u>12,133,590</u></b>

**Sqarim per moskuadrimin e te ardhurave:**

Sqarojme se moskuadrimi i te ardhurave te paraqitur ne FDP-te mujore ne shumen 64,183,066 leke me te ardhurat e paraqitura ne pasqyrat financiare ne shumen 57,605,387 leke, vjen si pasoje e paraqitjes se faturimeve te paradhenieve te arketuara nga klientet per shitjen e aparatamenteve ne shumen prej 6,577,679 leke, ne pasiv te pasqyrave financiare, ne postin “Arketime ne avance per porosi”.

**11. Lende e pare dhe materiale te konsumueshme**

Shuma e materialeve te konsumuara per vitin 2019 eshte 894,087 leke, si me poshte:

Emertimi	Viti 2019	Viti 2018
Kosto e materialeve te konsumuara	864,522	1,176,622
<b>Shuma I</b>	<b><u>864,522</u></b>	<b><u>1,176,622</u></b>
<b>Te tjera shpenzime</b>		
Lidhje e energjise elektrike	29,565	-
<b>Shuma II</b>	<b><u>29,565</u></b>	<b><u>-</u></b>
<b>Totali</b>	<b><u>894,087</u></b>	<b><u>1,176,622</u></b>

**12. Shpenzime te personelit**

Shpenzimet per koston e punes paraqiten ne shumen 3,105,236 leke si me poshte:

Nr	Kosto e Punes	Viti 2019	Viti 2018
1	Shpenzime per paga	2,660,865	2,608,716
2	Sigurime shoqerore dhe shendetesore	444,371	435,656
	<b>Shuma</b>	<b><u>3,105,236</u></b>	<b><u>3,044,372</u></b>

**Me poshte paraqitet permbledhesja e pagave per vitin 2019:**

Nr	Muaji	Nr punonj	Paga Totale Bruto	Paga mbi te cilen llog. kontributet	Kontribut. Punedhenesi	Kontribut Punemarresi	Tatimi ne leke	Paga neto
1	Janar	8	246,528	246,528	41,171	27,611	6,297	212,620
2	Shkurt	6	228,876	228,876	38,223	25,634	6,873	196,369

3	Mars	6	228,876	228,876	38,223	25,634	6,873	196,369
4	Prill	6	228,876	228,876	38,223	25,634	6,873	196,369
5	Maj	6	228,876	228,876	38,223	25,634	6,873	196,369
6	Qershor	6	228,876	228,876	38,223	25,634	6,873	196,369
7	Korrik	6	228,876	228,876	38,223	25,634	6,873	196,369
8	Gusht	6	228,876	228,876	38,223	25,634	6,873	196,369
9	Shtator	6	228,876	228,876	38,223	25,634	6,873	196,369
10	Tetor	5	194,443	194,443	32,472	21,778	6,297	166,368
11	Nentor	5	194,443	194,443	32,472	21,778	6,297	166,368
12	Dhjetor	5	194,443	194,443	32,472	21,778	6,297	166,368
	<b>Shuma</b>		<b><u>2,660,865</u></b>	<b><u>2,660,865</u></b>	<b><u>444,371</u></b>	<b><u>298,017</u></b>	<b><u>80,172</u></b>	<b><u>2,282,676</u></b>

### 13. Shpenzime Konsumi dhe Amortizimi

Paraqitet amortizimi i aktiveve afat gjata materiale per vitin 2019 ne shumen 308,639 leke, i llogaritur sipas normave ne fuqi.

Nr	Emertimi	Viti 2019	Viti 2018
1	Amortizim asetesh	308,639	378,179
	<b>Shuma</b>	<b><u>308,639</u></b>	<b><u>378,179</u></b>

### 14. Shpenzime te tjera shfrytezimi

Jane paraqitur shpenzime ne shumen 32,981,882 leke per vitin 2019, te cilat jane te detajuara si ne tabelen e meposhtme:

Nr	Emertimi	Viti 2019	Viti 2018
1	Kancelari	4,800	-
2	Sherbim kontabiliteti, noterie	524,912	397,640
3	Shpenzime telefonike	17,250	10,354
4	Kosto e objektit te shitur	31,341,790	3,881,172
5	Taksa lokale	564,043	525,558
6	Komisione bankare	53,076	50,187
7	Shpenzime riparimi	26,620	86,304
8	Shpenzime mirembajtje kompjuterash	6,000	-
9	Qera	443,391	458,313
10	Sigurim kontrate	-	1,000
	<b>Shuma</b>	<b><u>32,981,882</u></b>	<b><u>5,410,528</u></b>

### Sqarim per kuadrinin e shpenzimeve te deklaruar ne FDP mujore me shpenzimet e raportuara ne Pasqyrat Financiare te vitit 2019

Nr	Sipas FDP	Shuma ne leke
1	Blerje nga furnitore vendas	868,272
2	Blerje te perjashtuara	2,412,115
3	Blerje investimi brenda vendit pa tvsh	111,000
4	Blerje investimi brenda vendit	-
	<b>Totali I blerjeve</b>	<b><u>3,391,387</u></b>



<b>Nr</b>	<b>Sipas bilancit</b>	
1	Lende e pare dhe materiale te konsumueshme	864,522
2	Te tjera shpenzime	29,565
3	Shpenzime te tjera shfrytezimi	32,981,882
2	<i>korrigjohet me Ndryshimin e gjendjes</i>	-
3	Blerje AQT	111,000
	<b>Shuma</b>	<b><u>33,986,969</u></b>
<b>Nr</b>	<b>Diferenca fdp-bilanc e detajuar si me poshte</b>	<b>(30,595,582)</b>
1	Kalim ne kosto objekti per tu shitur viti 2019	(1,363,326)
2	Kosto e objektit te shitur, rimarrje	31,341,790
3	Taksa lokale	564,043
4	Komisione bankare	53,076
	<b>Diferenca</b>	<b><u><u>-</u></u></b>

### 15. Shpenzime financiare

Paraqiten shpenzime financiare per vitn 2019 ne shumen 241,751 leke, te detajuara si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2019	Viti 2018
1	Fitim/Humbje nga kembimet valutore	(66,137)	899,107
2	Te ardhura nga interesat	2,386	123
	<b>Shuma I</b>	<b><u>(63,752)</u></b>	<b><u>899,230</u></b>
3	Gjoha e penalitete	(111,492)	(912)
4	Shpenzime per tatim qeraje	(66,507)	(68,746)
	<b>Shuma II</b>	<b><u>(177,999)</u></b>	<b><u>(69,658)</u></b>
	<b>Totali</b>	<b><u><u>(241,751)</u></u></b>	<b><u><u>829,572</u></u></b>

### 16. Llogaritja e tatimit te fitimit

Shoqeria per vitin ushtrimor 2019 paraqitet me Fitim neto ne shumen 17,036,023 leke. Te permbledhura te ardhurat dhe shpenzimet e periudhes, paraqiten si me poshte:

Nr	EMERTIMI	VITI 2019	VITI 2018
1	Te ardhura	57,605,387	12,133,590
2	Shpenzime	(37,531,595)	(9,180,129)
3	<b>Rezultati</b>	<b><u>20,073,792</u></b>	<b><u>2,953,461</u></b>
4	Shpenzime te pazbritshme	177,999	69,658
5	<b>Rezultati per llogaritjen e tatim fitimit</b>	<b><u>20,251,791</u></b>	<b><u>3,023,119</u></b>
6	Perqindja e tatim fitimit	15	15
7	Tatim fitimi	3,037,769	453,468
8	<b>Fitimi neto i periudhes</b>	<b><u><u>17,036,023</u></u></b>	<b><u><u>2,499,993</u></u></b>

Shpenzimet e pazbritshme ne shumen 177,999 leke jane shpenzime te detajuara si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2019	Viti 2018
1	Shpenzime per tatim ne burim	66,507	68,746
2	Gjoha e penalitete	111,492	912
	<b>Shuma</b>	<b><u>177,999</u></b>	<b><u>69,658</u></b>

**17. Angazhime dhe pasiguri****Çeshtje gjyqesore**

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çeshtje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 Dhjetor 2019 Shoqëria nuk ka asnjë çeshtje gjyqesore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, qe mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

**18. Ngjarje pas datës së Bilancit**

Situata e krijuar gjatë periudhës së fatkeqesise natyrore, të shpallur si pasoje e COVID-19, nuk ndikon në biznesin tone dhe si pasoje nuk prek parimin e vijimesise, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

**Administratori****Beqir Shehu**